



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-400/03-0051745-2/26 dt. 01.09.2026
Mitrovicë

NJOFTIM

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 3, i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës; nenin 61 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-048 Për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë; neneve 17 paragrafi 1, 19 dhe 22 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 Për Administratë të hapur në Komuna; në nenin 25 dhe 26 të Statutit të Komunës; bazuar në Planin e veprimit për transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2023-2027, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Safet Kamberi në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Informim ORGANIZON:

KONSULTIM PUBLIK

PËR

PROJEKT BUXHETIN E KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT PËR VITIN 2027 DHE VLERËSIMET PËR VITET 2028-2029

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në Konsultimin Publik për Projekt buxhetin e Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029.

Konsultimi publik do të mbahet të mërkurën më dt. 09.09.2026 në Sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora 10.⁰⁰.

Njëkohësisht të gjithë qytetarët dhe të interesuarit tjerë në afatin prej 15 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi të gjitha propozimet, komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i bëjnë përmes ueb faqes së Komunës <https://kk.rks-gov.net/mitroviccejugut/>, ose te Udhëheqësi i Sekretarisë së Kuvendit z. Nazmi Jashari në e-mailin: nazmi.jashari@rks-gov.net, ose drejtpërdrejtë në Zyrën pritëse dhe Zyrën Nr. 60 të Sekretarisë së Kuvendit të Komunës, ku edhe mund të merret Projekt buxheti për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029.

Projekt buxhetin e Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029 po ashtu mund ta gjeni të publikuar në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut duke klikuar linkun: <https://kk.rks-gov.net/mitroviccejugut/category/shpalljet/njoftimet/>.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit
Safet KAMBERI